Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0802

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje ngaVjosa Gradinaj Mexhuaniduke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.N.T. "Korabi", kundër Vendimin për dhënie të kontratës ose të një konkursi të projektimit të KK Skenderaj në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "057 - Kanalizimi fekal Izbicë, Rakinicë dhe Leqinë - Faza 1 – Ri-tender" me numër të prokurimit 643-23-8683-5-2-1, me 26/12/2023, mori:

Vendim

1.Aprovohet si e bazuar ankesa e OE N.N.T. "Korabi", me nr. 2023/0802, e datës 16/10/2023, kurse vendimi i AK KK Skenderaj lidhur me aktivitetin e prokurimit "057 - Kanalizimi fekal Izbicë, Rakinicë dhe Leqinë - Faza 1 – Ri-tender" me numër të prokurimit 643-23-8683-5-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik N.N.T. "Korabi"

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.08.2023,"KK Skenderaj" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "057 - Kanalizimi fekal Izbicë, Rakinicë dhe Leqinë - Faza 1 – Ri-tender". Ndërsa me datën 02.10.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë N.N.P "Ndërtimi".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 65,000 €.

Me 06.10.2023, OE N.N.T. “Korabi”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 09.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16/10/2023, kundër vendimit të cituar si më sipër OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.N.T. “Korabi”, me nr. 802/23.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Pretendimet e operatorit ekonomik ankuesN.N.T. “Korabi”, janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi ankimore: **“**Me dt. 02.10.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE NNP Ndërtimi, ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues te eliminuar me arsyetimin si ne vijim: Arsyeja e eliminimit është shume e paqartë dhe konfuze sepse nuk është cek asnjë mungese konkrete e dëshmive ne lidhje me kontratat dhe stafin që ne kemi ofruar. Sa i përket përvojës se stafit të kualifikuar, ne i kemi ofruar dëshmitë sipas kërkesës, ndërsa nëse autoriteti kontraktues ka pasur dilema në lidhje me ndonjë dëshmi, qoftë për kontrata apo për dëshmitë ne lidhje me stafin, atëherë është dashur te veprohet ne harmoni me nenin 59.2 dhe 72 te LPP-se dhe të kërkohen sqarime shtesë. Sidoqoftë, ne lidhje me stafin profesional ju sqarojmë se inxhinieri B.M. (emri në shkresat e lëndës) është i punësuar tek ne qe shume vite dhe ka përvojë me shume se sa është kërkuar ne dosje te tenderit. Me kërkese për rishqyrtim ne e kemi bashkangjitur referencën për inxhinierin ne fjale, ku dëshmohet qe i njëjti ka përvojë me shume se sa është kërkuar. Të njëjtën Reference po ua bashkëngjisim edhe me ankese, e ku dëshmohet përvoja e tij e punës. Po ashtu me kërkesa për rishqyrtim kemi bashkangjitur edhe referencën për gjeodetin D. H.(emri në shkresat e lëndës), ku dëshmohet përvoja e punës. Për këto dëshmi, autoriteti kontraktues ka mundur të kërkojë sqarime shtese sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se. mirëpo ne këtë rast nuk është shfaqur një vullnet i tille. Këto dispozita medoemos duhet te zbatohen sidomos kur kemi te bëjmë me raste kur ofertuesi është me çmim me te ulet, sikurse ne tani. Ne kemi ofertuar me çmim me të lire se te gjithë kompanitë tjera dhe nuk duhet lejuar që te dëmtohet buxheti i shtetit e mos te kërkohen sqarime. Neni 59.2 i LPP-se e parasheh qarte që sqarime mund te kërkohen mbi cilindo aspekt te tenderit. Pavarësisht se neve nuk na është dhënë një arse konkrete e eliminimit, ne i kemi dhëne këto sqarime ne kërkese për rishqyrtim e po ashtu edhe me ankese i kemi elaboruar çështjen e dëshmive për dy inxhinieret ne fjale. Nga dëshmitë e bashkangjitura me dosje të tenderit është kuptuar se inxhinieret kanë përvojë te mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e FDT-se dhe kjo është vërejtur edhe nga CV e edhe nga datat e diplomimit, mirëpo ne këto raste kur ka dilema apo mungon ndonjë reference mund te kërkohen sqarime shtese. Vendimin për refuzim te kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.

11.10.2023, mirëpo ky vendim nuk është arsyetuar fare dhe ne këtë rast është vepruar në kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 9 të LPP-së. Madje në diapozitiv të këtij vendimi shkruan se aprovohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim. Në mungese te argumentimit dhe arsyetimit te vendimit të tyre, AK-se vetëm i ka përsëritur konstatimet kundërligjore të tyre. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken me larte, konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bëre ne harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse ne jemi eliminuar pa të drejtë edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate. Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie te kontratës e qe ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-s°, sepse ne jemi operator ekonomik i përgjegjshëm dhe me çmim me të ulet. Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 1 LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate, ndërsa neve jemi diskriminuar duke u eliminuar pa të drejte ne këtë aktivitet te prokurimit. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se, e parasheh qarte që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente. Gjithashtu nuk është marr ne konsiderate edhe neni 1 dhe 6 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroje mënyrën me efikase, me transparente dhe m te drejte te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove. shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoritetit kontraktues ne Kosovë Duke u referuar pretendimeve si më sipër N.N.T. "Korabi", konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin **1, 6, 7, 59, 69, 72** të LPP-së, si dhe neni **40** të rregullores nr. 001/2022 për prokurim publik. Duke propozuar qe ankesa te aprovohet si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Me 09.10.2023, Autoriteti Kontraktues ne vendimin ndaj kerkeses per rishqyrtim, ka pohuar shkurtimisht se OE ankues ka ofertuar në kundërshtim me kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit, ngase nuk ka ofruar deshmitë e kërkuara sa i përket përvojes per dy ingjinierët, rrjedhimisht ka kërkuar që ankesa të refuzohet kurse të vërtetohet vendimi i AK për dhënie.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26/10/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 802/23, ndërsa me datë 01/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0802 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues:

- që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar,
- të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, "Autoriteti kontraktues nuk ka kthyer përgjigje. Ndërsa OE Pajtohet me raportin e eksperti shqyrtues"

Lidhur me pretendimet e OE N.N.T. "Korabi", ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 202/0802 ka vlerësuar si në vijim:

Ekspertja shqyrtuese sqaronOE ankues pretendon se arsyeja e eliminimit sipas tij/saj është shumë e paqartë dhe konfuze ngase nuk është cek asnjë mungesë konkrete e dëshmive në lidhje me kontratat dhe stafin kishin ofruar. Sa i përket përvojës së stafit të kualifikuar, ankuesi sqaron se i kishin ofruar dëshmitë sipas kërkesës, ndërsa nëse eventuliasht autoriteti kontraktues ka

pasur dilema në lidhje me ndonjë dëshmi, qoftë për kontrata apo për dëshmitë në lidhje me stafin, është dashur të veprohet në harmoni me nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe të kërkohen sqarime shtesë. Sidoqoftë, në lidhje me stafin profesional ka sqaruar se inxhinieri B. M. është i punësuar tek OE që shumë vite dhe po ashtu ka përvojë më shumë se sa është kërkuar realisht në dosje të tenderit. nga ana tjtër ne me kërkesë për rishqyrtim i kemi bashkangjitur edhe referencën për inxhinierin në fjalë, ku dëshmohet fare qartë se i njëjti ka përvojë më shumë se sa është kërkuar. Të njëjtën Referencë e kemi bashkëngjitur edhe me ankesë, e ku dëshmohet përvoja e tij e punës. Po ashtu me kërkesë për rishqyrtim e kemi bashkangjitur edhe referencën për gjeodetin D. H., ku dëshmohet përvoja e punës. Për këto dëshmi, AK ka mundur ti kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, mirëpo në këtë rast nuk ka shfaqur një vullnet i tillë. Këto dispozita medoemos duhet të zbatohen sidomos kur kemi të bëjmë me raste kur ofertuesi është me çmim më të ulët, sikurse ne tani. Ne kemi ofertuar me çmim më të lirë se të gjithë kompanitë tjera dhe nuk duhet lejuar që të dëmtohet buxheti i shtetit e mos të kërkohen sqarime. Neni 59.2 i LPP-së e parasheh qartë që sqarime mund të kërkohen mbi cilindo aspekt të tenderit."

Lidhur me këtë Ekspertja shqyrtuese konstaton dhe sqaron se në Dosjen e Tenderit një nga dëshmitë për kërkesat teknike dhe profesionale ka qenë që për stafin i cili angazhohet në këtë projekt, Operatorët Ekonomik duhet të ofrojnë CV-në si dhe dëshmia mbi përvojën e punës së kërkuar, edhe pse nga ana e AK-së nuk është cekur saktësisht se cilat janë dokumentet e pranueshme përmes të cilave mund të dëshmohet përvoja e kërkuar. OE ankues në ofertë, nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi të përvojës së punës për menaxherin e projektit dhe inxhinierin e gjeodezisë, CV-ja e dorëzuar është një pasqyrim i përgjithshëm i kualifikimeve dhe përvojës së stafit por nuk janë dëshmi të përvojës në punë siç është kërkuar. Duke e marr parasysh situatën reale, Autoriteti Kontraktues sipas nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik është dashur të kërkoj sqarime shtesë për dëshmitë e përvojës së punës të cilat mungojnë edhe pse po e ritheksoj se askund në DT nuk është cekur se çfarë dokumente duhet të ofrohen nga ana e operatorëve për të dëshmuar përvojën në punë. Çdo dokument i pranuar përmes sqarimeve shtesë duhet të ketë të fiksuar datën e lëshimit përmes të cilës në mënyrë objektive mund të vërtetohet ekzistenca e këtyre dokumenteve para datës së fundit të hapjes së tenderëve. Sipas ekspertit shqyrtues, eliminimi i menjëhershëm i OE ankues pa kërkuar sqarime shtesë siç e lejon edhe LPP, nga ana e Autoritetit Kontraktues nuk duket aspak e drejtë. Po ashtu eksperti pasqyron se OE ankues bashkë me kërkesën për rishqyrtim ka dorëzuar edhe dy referenca të përvojës së punës për stafin e angazhuar, por përgjigja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim nuk ka qenë në përputhje me Neni 108/A, për arsye se AK nuk është përgjigjur në pretendimet e ngritura nga OE në kërkesën për rishqyrtim, ashtu siç e kërkon ky nen. Në rastin konkret, eksperti vlerëson se AK nuk ka vepruar në përputhje me LPP-në dhe neni 72 dhe 108/A. Duke u bazuar në atë çfarë sqaruam më lartë, eksperti vlerëson që pretendimi i ngritur nga OE ankues **është i bazuar."**

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.N.T. "Korabi", Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.N.T. "Korabi" janë të bazuara.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdes profesional i ka administruar dhe vlerësuar të gjitha provat në shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 59 të LPP, përderisa nuk i ka përdorur apo zbatuar me kohë dhe gjatë rrjedhës së aktivitetit kompetencat e tij në vështrim të paragrafit 2, të dispozitës së cituar sipas së cilës, AK mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve, meqenëse në rastin konkret AK në Dosjen e Tenderit në njërën nga dëshmitë për kërkesat teknike dhe profesionale kishte kërkuar për stafin i cili angazhohet në këtë projekt OE duhet të ofrojnë CV-në si dhe dëshmia mbi përvojën e punës së kërkuar, nga ana tjetër edhe pse AK-së nuk kishte cekur saktësisht se cilat janë dokumentet/dëshmi do jenë të pranueshme përmes të cilave mund të dëshmohet përvoja e kërkuar e punës. Sipas konstatimeve të ekspertit shqyrtues OE ankues në ofertë, nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi të përvojës së punës për menaxherin e projektit dhe inxhinierin e gjeodezisë, mirëpo ka dorëzuar CV e cila është një pasqyrim i përgjithshëm i kualifikimeve dhe përvojës së stafit. Andaj duke e marr parasysh situatën reale, AK sipas nenit 59.2 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, është dashur të kërkoj sqarime shtesë për dëshmitë e përvojës së punës të cilat mungojnëqoftë për kontrata, referenca për përvojën e punës etj, gjithnjë në zbatim po ashtu të nenit 1,6,7 të LPP-së. Ngase përmes nenit 1 të LPP përcaktohet se "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese...". përmes nenit 6 përcaktohet se "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".

Prandaj, Paneli bazuar në të lartcekurat thekson që AK me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të drejtë të ofertave duhet të kërkoj edhe sqarime shtesë nga ofertuesit tjerë në kuptim të nenit 59 dhe 72 të LPP lidhur me nenin 38 paragrafin 38.1 të RRPP. Përmes nenit 72 të LPP përcaktohet se "Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji" kurse parg.3 përcaktohet "Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive". Ndërsa përmes nenit 38 paragrafit 38.1 të RRPP përcaktohet se "Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigja bëhen përmes platformës elektronike" paneli sqaron për AK se gjithnjë sqarimet të kërkohen dhe të pranohen si të tilla duke u bazuar në përmbajtjen e CV të prezantuara nga Ankuesi.

Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues,

analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit me titull "057 - Kanalizimi fekal Izbicë, Rakinicë dhe Leqinë - Faza 1 – Ri-tender" të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veproj në plotni me dispozitat ligjore të LPP-së ,kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **K.K. SKENDERAJ**
- OE - **N.N.T. " Korabi "**
- Arkivës së OSHP-së: